PSH.nr.927/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "PBC" sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "DLD GROUP"- Prishtinë - lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit: GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Graçanicë, më datën: 04.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "PBC" Sh.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit: GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Graçanicë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit: GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Graçanicë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "PBC" Sh.P.K-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "PBC" Sh.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 12.11.2020 me nr. 927/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit: GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Graçanicë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 paragrafi 2 dhe nenin 59 paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 23.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet ka nxjerrë vendimin me numër 709/20.

Pretendimet ankimor të OE ankues sipas kësaj ankesë kanë të bëjë me vendimin e AK-së për shpërblim me kontratë OE "DLD GROUP" Sh.P.K.

OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 02.11.2020. Përderisa, AK me datë 03.11.2020, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa dhënë sqarime konkrete për shqyrtimin e pretendimeve ankimore, por ka theksuar se AK ka vepruar sipas vendimit të OSHP-së 709/20.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1 - OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushë specifikat teknike të dosjes së tenderit.

Në dosjen e tenderit, Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, AK në tri pika ka kërkuar që OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit gjatë ofertimit të ofrojnë dëshmi apo përshkrime për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit.

Fillimisht, për pozicionin 1, është përshkruar kërkesa H si vijon: "*.....Gjatë fazës së ofertimit, OE duhet të*

dorëzojë të paktën 1 mock-ups të detajuar me dimensione të e-Kioskut. Po ashtu, OE duhet të dëshmojë përmes fotografive implementimin e të paktën 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe të shkruajë AK ku janë implementuar. ....."

Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është dorëzuar edhe dokumenti "15.KIOSKA". Në këtë dokument janë paraqitur tri imazhe ilustruese për e-kioskun. Megjithatë në këtë dokument nuk janë ofruar informata për dimensionet ashtu sikurse është kërkuar. Ndërsa, lidhur me dëshmitë për implementimin e 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe informacionet e AK-ve se ku janë implementuar, OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave nuk ka paraqit imazhe, mirëpo OE ankues ka dorëzuar një broshurë të komunës së Prishtinës për e-kioskun e vendosur në Komunën e Prishtinës.

Më tej, në pozicionin 2, pika 2.5 AK ka kërkuar që "..... *OE i cili është po ashtu i obliguar që gjatë ofertimit të përshkruajë edhe mënyrën se si do e realizojë."* OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar dëshmi se si do ta realizojë lidhjen e softuerit të e-kioskut me bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror Civil të ARC-së.

Në fund, poashtu për pozicionin 2, pika 2.8 AK ka kërkuar që "....*E-Kiosku duhet të ofrojë komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin."*

Edhe për këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar përshkrimin apo zgjidhjen për këtë kërkesë.

Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, për shkak se nuk janë dhënë dimensionet e e-kioskut, nuk ka dëshmi për e-kiosqe që janë implementuar me informatat e AK-ve, nuk ka ofruar përshkrimin se si do ta realizojë lidhjen e softuerit me bazën qendrore të të dhënave të ARC-së dhe nuk ka ofruar modalitet për relizimin e komunikimit sipas pikës 2.8, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

<u>Përgjigje në Pretendimin Ankimor 2</u>- OE ankues gjithashtu pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbushën specifikimet teknike të dosjes së tenderit në disa pozicione tjera sipas broshurës së dorëzuar.

AK përmes e-mailit me datë 19.11.2020 ka sqaruar se gjatë fazës së rivlerësimit nuk ka kërkuar informacione shtesë, mirëpo i referohet broshurës së dorëzuar së bashku ankesën 709/20 nga OE "DLD Group" dhe thekson se OSHP e ka marrë për bazë këtë dokument gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20. Vlen të theksohet se as në Raportin e Ekspertizës dhe as në Vendimin e Panelit Shqyrtues një dokument i tillë nuk është marrë për bazë gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20.

Në lidhje me mospërmbushjen e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit sipas modelit të ofruar në broshurën e bashkangjitur me ankesë, ritheksojmë se ashtu sikurse është sqaruar në raportin paraprak që lidhet me ankesën 709/20 një dokument i tillë nuk është kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së

tenderit. Andaj, konsiderojnë se ky pretendim ankimor është trajtuar në raportin paraprak dhe vendimin e Panelit Shqyrtues dhe ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2020, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2. Në të njëjtën kohë njoftohet Paneli Shqyrtues se ky pretendim është trajtuar e për të cilin është vendosur sipas vendimit numër 709/20, të datës 27.10.2020.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, Nuk ka pergjigje

Operatori Ekonomik, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

NGA: PBC Sh.P.K., me adresë në Rrugën Idriz Gjilani, p.n. 10000 Prishtinë, përfaqësuar nga Granit Vokshi, avokat, me adresë në Rrugën Robert Doll, Nr.34 10000 Phshtinë

PËR: Organin Shqyrtues të Prokurimit

LËNDA: Përgjigje ndaj Raporrit të Ekspertit sa i përket aktivitetit të prokurimit "Fumizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues — Kuvendi Komunal — Graçanicë

Të nderuar,

Me anë të kësaj Përgjigje — ju njoftojmë se më 23 nëntor 2020, kemi pranuar raportin e ekspertit 927/20 në hdhje me ankesën e OE Ankues PBC Sh.P.K., të deponuar më 12 nëntor 2020, sa i përket akrivitetit të prokurimit "Fumizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues — Kuvendi Komunal — Graçanicë.

Me këtë rast — ju njoftojmë OE Ankues PBC Sh.P.K., *nëparim*, pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, i cih propozon që Ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe kjo lëndë të kthehet në rishqyrtim.

Megjithatë — OE Ankues, me këtë rast, do t'i parashtrojë disa nga mospajtimet e tij në raport me këtë ekspertizë.

Mos-pajtimi i OE Ankues hdhet me pjesën ku thuhet: "OE i rekomanduar për kontratë në hstën e kontratave nuk ka paraqitë imazhe, mirëpo OE ankues ka dorëzuar një broshurë të komunës së Prishtinës për e-kioskun e vendosur në Komunën e Prishtinës."

Për hir të sqarimit, kërkesa e AK-së ka qenë: "OE *duhet të dëshmojëpërmesfotografive implementimin e të pàkësën 3 e-Ydoskave në ambientet ejashtme dhe tëshkruajAK se kujanëimplementuar"*

Lidhur me këtë — OE sqaron Organin Shqyrtues të Prokurimit, se fotografia e bashkangjitur nga OE i rekomanduar (për kontratë), nuk është e implemtuar në ambiente të jashtme dhe nuk posedon pajisjet për implementim të ambiente të jashtme. E njëjta ka komizë të xhamit, ashtu që nëse e njëjta do të ishte për ambiente të jashtme, nuk do te kishte nevoje për komizë te xhamit, për këto arsye dhe nuk mund të hogaritet që është e implemtuar në ambiente të jashtme, siç parashihet në kërkesën e AK-së. Sikur e njëjta të ishte impelemtuar në ambiente të jashtme dhe të kishe komponentët për ambiente te jashtme, edhe në atë rast, OE i rekomanduar për kontratë, nuk e përmbush kërkesën e AK, pasi qe AK, ka kërkuar **minimum tre (3)** implementime në ambiente të jashtme, kështu duke bashkangjitur fotografitë edhe AK-së.

Provë: Fotografia për një (1) implementim

Po ashm — ritheksojmë faktin se, në rast se nuk mirret për bazë broshura e OE të rekomanduar, i njejti ka dështuar të ofrojë zgjidhje apo ofertë teknike, sipas kërkesës së AK-së, sepse i njejti vetëm e ka vulosur kërkesën e AK-së, duke dështuar të specifikojë se çfarë përfshinë oferta e tij. Këtu vëmë theksin edhe tek dokumenti i cih është dorëzuar më vonë — i nënshkruar — ky dokument ka ardhë si rezultat i kërkesës së AK, e i njejti nuk është dorëzuar në momentin e dorëzimit të ofertës së OE të rekomanduar.

Kësisoj — OE Ankues, kërkon nga OShP që këtë Aktivitet të Prokurimit — bazuar në Ankesën e datës 12 nëntor 2020 dhe në mendimin e ekspertit shqyrtues — ta kthej në Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, me udhëzimet e qarta të eliminimit të shkeljeve të cilat e kanë karakterizuar deri më tani këtë aktivitet të prokurimit, pasi që AK — nuk e ka trajtuar ofertën sipas udhëzimeve të OShP-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 00.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PBC" sh.p.k-Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushë specifikat teknike të dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit, Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, AK në tri pika ka kërkuar që OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit gjatë ofertimit të ofrojnë dëshmi apo përshkrime për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit.

Fillimisht, për pozicionin 1, është përshkruar kërkesa H si vijon: "*.....Gjatë fazës së ofertimit, OE duhet të dorëzojë të paktën 1 mock-ups të detajuar me dimensione të e-Kioskut. Po ashtu, OE duhet të dëshmojë përmes fotografive implementimin e të paktën 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe të shkruajë AK ku janë implementuar. .....*"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është dorëzuar edhe dokumenti "15.KIOSKA". Në këtë dokument janë paraqitur tri imazhe ilustruese për e-kioskun. Megjithatë në këtë dokument nuk janë ofruar informata për dimensionet ashtu sikurse është kërkuar. Ndërsa, lidhur me dëshmitë për implementimin e 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe informacionet e AK-ve se ku janë implementuar, OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave nuk ka paraqit imazhe, mirëpo OE ankues ka dorëzuar një broshurë të komunës së Prishtinës për e-kioskun e vendosur në Komunën e Prishtinës.

Më tej, në pozicionin 2, pika 2.5 AK ka kërkuar që "..... *OE i cili është po ashtu i obliguar që gjatë ofertimit të përshkruajë edhe mënyrën se si do e realizojë."* Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar dëshmi se si do ta realizojë lidhjen e softuerit të e-kioskut me bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror Civil të ARC-së.

Në fund, po ashtu për pozicionin 2, pika 2.8 AK ka kërkuar që "....*E-Kiosku duhet të ofrojë komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin."* Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe për këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar përshkrimin apo zgjidhjen për këtë kërkesë. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, për shkak se nuk janë dhënë dimensionet e e-kioskut, nuk ka dëshmi për e-kiosqe që janë implementuar me informatat e AK-ve, nuk ka ofruar përshkrimin se si do ta realizojë lidhjen e softuerit me bazën qendrore të të dhënave të ARC-së dhe nuk ka ofruar modalitet për relizimin e komunikimit sipas pikës 2.8, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PBC" sh.p.k-Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbushën specifikimet teknike të dosjes së tenderit në disa pozicione tjera sipas broshurës së dorëzuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK përmes e-mailit me datë 19.11.2020 ka sqaruar se gjatë fazës së rivlerësimit nuk ka kërkuar informacione shtesë, mirëpo i referohet broshurës së dorëzuar së bashku ankesën 709/20 nga OE "DLD Group" dhe thekson se OSHP e ka marrë për bazë këtë dokument gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20. Vlen të theksohet se as në Raportin e Ekspertizës dhe as në Vendimin e Panelit Shqyrtues një dokument i tillë nuk është marrë për bazë gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me mos përmbushjen e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit sipas modelit të ofruar në broshurën e bashkangjitur me ankesë, ritheksojmë se ashtu sikurse është sqaruar në raportin paraprak që lidhet me ankesën 709/20 një dokument i tillë nuk është kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është trajtuar në raportin paraprak dhe vendimin e Panelit Shqyrtues dhe ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2020,

përkatësisht nenin 16, paragrafi 2. Në të njëjtën kohë njoftohet Paneli Shqyrtues se ky pretendim është trajtuar e për të cilin është vendosur sipas vendimit numër 709/20, të datës 27.10.2020.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti shqyrtoj të gjitha udhëzimet e dhëna në vendimet paraprake, si dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Bicrim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK Graçanicë";

1x1 OE "PBC" Sh.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.